



Periodiku AMF

I. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF dhe BQK në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorëve financiarë jobankarë

Me ftesë të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Z. Hashim Rexhepi, një ekip i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) i kryesuar nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni, kreu një vizitë dy ditore në Kosovë në datat 20 dhe 21 Nëntor 2008. Qëllimi kryesor i vizitës ishte nënshkrimi i marrëveshjes dypalëshe të mirëkuptimit në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorëve financiarë jobankarë në të dy vendet.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura
II. 1 Tregu shqiptar i sigurimeve krahasuar me rajonin gjatë vitit 2007

Në Evropën Lindore për vitin 2007, pati një rritje të primeve në terma real prej 12% në sigurimin e Jo Jetës dhe 14% në atë të Jetës. Ndërkohë, në Shqipëri, rritja e primeve të shkruara bruto për vitin 2007 ishte 31%. Duke marrë parasysh inflacionin mesatar të vitit 2007 afërsisht 3%, kjo rritje në terma real përsëri paraqitet me dinamikë më të lartë, krahasuar me Evropën Lindore.

Vijon në faqen 3

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera
III. 1 Ç'është Programi SECE CRIF - Shqipëria, vendi i parë pjesëmarrës

Objektivat e Programit. SECE CRIF do të ngrihet në formën e një partneriteti të drejtë publik – privat, me objektiv themelor zhvillimin e shpejtë të tregut të sigurimit të katastrofave në Evropën Juglindore, duke u dhënë kështu mundësi pronarëve të banesave apo të bizneseve të mesme e të vogla, të sigurohen kundrejt riskut të katastrofave me çmime të përballueshme.

Vijon në faqen 5

III. 2 Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian e IOSCO - s

Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian (ERC) e IOSCO - s, u zhvillua në datën 3 nëntor 2008, në

Madrid, Spanjë, në zyrat qendrore të IOSCO - s. IOSCO është një organizatë ndërkombëtare që mbledh rregullatorë nga mbarë bota për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve të kapitalit.

Vijon në faqen 7

III. 3 Zhvillohet Konferenca e 4-t Ndërkombëtare "Për Sigurimin e Jetës në Evropën Lindore, CIS dhe Azi."

Në datat 13-14 nëntor, Varshavë, Poloni, u zhvillua Konferenca e 4-t Ndërkombëtare "Për Sigurimin e Jetës në Evropën Lindore, CIS dhe Azi."

Vijon në faqen 8

III. 4 Zhvillohet takimi i përgjithshëm vjetor i IOPS dhe Forumi Global i OECD/IOPS për pensionet private "Zhvillimet e Pensioneve në Afrikë: Mundësi dhe Sfidë"

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me OECD dhe Autoritetin e Përfitimeve të Pensioneve të Kenias, (RBA) zhvilluan në Mombasa, Kenia gjatë periudhës 28-31 Tetor 2008, takimet e mëposhtme:

a) Takimi i Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS në datë 28-29 Tetor 2008

Vijon në faqen 9

IV. Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

Kapitulli 1
Nevoja në rritje për ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi risqet dhe çështjet e sigurimeve (Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private)

1. Evoluimi i risqeve dhe nevojave të shoqërisë për mbulim me sigurim

Rritja e risqeve të njohur dhe realë
Risqet e reja dhe të katastrofës janë aspektet më të prekshme të rritjes së niveleve të risqeve.

Vijon në faqen 10

Në këtë numër:

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF dhe BQK në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorëve financiarë jobankarë

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

10

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis AMF dhe BQK në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorëve financiarë jobankarë



Zj. Elisabeta Gjoni dhe Z. Hashim Rexhepi në nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

Me ftesë të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Z. Hashim Rexhepi, një ekip i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) i kryesuar nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni, kreu një vizitë dy ditore në Kosovë në datat 20 dhe 21 Nëntor 2008. Qëllimi kryesor i vizitës ishte nënshkrimi i marrëveshjes dypalëshe të mirëkuptimit në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorëve financiarë jobankarë në të dy vendet.

Takimet e Kryetares Gjoni dhe ekipit të AMF-së, me përfaqësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, prekën çështje të rëndësishme të zhvillimit të sektorëve të sigurimeve, pensione dhe letrave me vlerë, dhe u ndalën në rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh.

Guvernatori Rexhepi bëri një përmbledhje të gjendjes së tregjeve financiare në Kosovë dhe rolin që luan BQK-ja në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Ligji i ri i miratuar nga

Parlamenti për Bankën Qendrore të Kosovës, përcakton qartë funksionet dhe rolin e këtij institucioni, si dhe rregullat themelore për operatorët në menaxhimin e qeverisjes dhe mbajtjen e parametrave financiarë e teknikë. Banka Qendrore e Kosovës po bashkëpunon ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore në realizimin e një sërë projektesh ambicioze që përfshijnë përmirësimin e kuadrit ligjor, metodologjitë moderne të mbikëqyrjes dhe informatizimin e proceseve në rregullimin e tregut financiar jobankar.



Takim i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni me Guvernatorin Rexhepi në BQK

Nga ana e saj, Kryetarja Gjoni, pasi shprehu konsideratat për zhvillimet inkurajuese në ekonominë Kosovare dhe në rregullimin e tregut financiar në veçanti, njohu pjesëmarrësit në takim me zhvillimet më të fundit të tregjeve në Shqipëri dhe punën e AMF-së për rishikimin e legjislacionit që rregullon sektorët e mbikëqyrur, përfshirjen e elementëve të rrezikut në metodologjinë e mbikëqyrjes dhe ngritjen e platformave elektronike mbështetëse.

Të dy përfaqësuesit i vunë theksin rëndësisë së madhe të bashkëpunimit në zhvillimin e shëndoshë të tregjeve financiare jobankare. Kufijtë midis dy tregjeve nuk ekzistojnë dhe kjo shprehet më së miri në investimet e ndërsjellta

në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për këtë arsye është e domosdoshme të përcillen në mënyrë të ndërsjelltë përvojat, të njësohen praktikat më të mira rregullative dhe të forcohen urat e bashkëpunimit në mbikëqyrjen e tregjeve. Marrëveshja e mirëkuptimit e pranuar nga palët është shprehja më e mirë e vullnetit dypalësh për bashkëpunim.

Në ditën e dytë të vizitës, në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Kjo marrëveshje u bë e domosdoshme pas ristrukturimit të rregullatorëve financiarë të të dy vendeve, dhe plotësoi memorandumin e mëparshëm në fushën e sigurimeve me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit edhe në sektorët e tjerë financiarë jo bankarë, si ai i pensioneve, i letrave me vlerë, etj.

Marrëveshja u nënshkrua nga Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së dhe Z. Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Arben Çejku, Kryetari i Bordit të BQK-së z. Gazmend Luboteni, si edhe drejtues të tjerë nga AMF dhe BQK.

Bashkëpunimi midis të dy institucioneve ka qenë i pandërprerë dhe shumë efektiv, ndërkohë që marrëveshja e nënshkruar rrit edhe më tej mundësitë dhe hapësirat në shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit, ekspertizës dhe përvojës së ndërsjelltë.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

I. Tregu shqiptar i sigurimeve krahasuar me rajonin gjatë vitit 2007

Në Evropën Lindore për vitin 2007, pati një rritje të primeve në terma real prej 12% në sigurimin e Jo Jetës dhe 14% në atë të Jetës¹. Ndërkohë, në Shqipëri, rritja e primeve të shkruara bruto për vitin 2007 ishte 31%. Duke marrë parasysh inflacionin mesatar të vitit 2007 afërsisht 3%, kjo rritje në terma real përsëri paraqitet me dinamikë më të lartë, krahasuar me Evropën Lindore. Ndërsa tregjet në veçanti për vitin 2007 janë rritur përkatësisht; Jo Jeta me 30% dhe Jeta me 33%, pa marrë parasysh efektin e inflacionit rreth 3%. Primi për frymë në (USD / frymë) për vitin 2007 për Shqipërinë, krahasuar me vendet e Evropës Lindore, mbetet në nivele të pakënaqshme, përkatësisht 16.77 USD / frymë Jo Jeta dhe 1.25 Jeta, kundrejt shifrave të vendeve të Evropës Lindore, përkatësisht 56 USD / frymë Jeta dhe 173.5 Jo Jeta.

Periudha janar - tetor 2008

Në periudhën janar - tetor 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 5,977,768 mijë lekë, përkundrejt 4,967,253 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 20.34% nga viti i kaluar, ku 89.96% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 10.04% tregut të sigurimeve të Jetës. Tregu vazhdon të ruajë dinamikën e rritjes që shfaqti në vitin 2007 edhe pse me një ritëm pak më të ulët.

Tregu i Jetës, megjithëse është një treg ende i vogël, në periudhën janar-tetor 2008, pati një rritje prej 31.13% në primet e shkruara bruto, ndërsa në tregun e Jo-Jetës primet e shkruara bruto patën një rritje prej 19.59 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në qoftë se do të krahasonim këtë periudhë me atë të dy viteve më parë, shohim se në periudhën janar - tetor 2008 primet e shkruara

¹ National insurance authorities, Swiss Re Economic Research & Consulting (Emerging markets developments).

bruto krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2006 kanë pësuar një rritje afërsisht 65.43% dhe një rritje mesatare për dy vitet radhazi afërsisht 29%.


Në periudhën janar - tetor 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm është rritur në masën 2.19%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës është rritur në masën 61.47%.

Në periudhën janar - tetor 2008 u lidhën 571,082 kontrata sigurimi përkundrejt 457,049 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 524,970 nga 423,880 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli “Sigurimi i shëndetit” ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 68,450 kontrata ose në masën 75.83% më shumë se janar - tetor 2007.


Vlen të përmendet rritja në masën 39.02% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 46,112, nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” ka një rritje prej 6,919 kontrata ose 68.21%, duke shënuar dhe

dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - tetor 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar - tetor 2008 (Jo Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - tetor (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2007	2008
Periudha janar - tetor		
A) Sigurim i Jetës	325,844	427,283
B) Sigurim i Jo - Jetës	4,641,410	5,550,485
<i>nga këto :</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	3,279,060	3,350,743
b) Sigurimi Vullnetar	1,362,350	2,199,742
TOTAL	4,967,253	5,977,768

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - tetor 2008 kapi vlerën 1,259,783 mijë lekë, ose 14.60% më shumë se në janar - tetor të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 989,026 mijë lekë, apo 80.63% të totalit. Në portofolin "Kartoni Jeshil" kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 12.08% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 22.32% krahasuar me 10 mujorin e parë të vitit 2007.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. Ç'është Programi SECE CRIF² - Shqipëria, vendi i parë pjesëmarrës

Objektivat e Programit. SECE CRIF do të ngrihet në formën e një partneriteti të drejtë publik – privat, me objektiv themelor zhvillimin e shpejtë të tregut të sigurimit të katastrofave në Evropën Juglindore, duke u dhënë kështu mundësi pronarëve të banesave apo të bizneseve të mesme e të vogla, të sigurohen kundrejt riskut të katastrofave me çmime të përballueshme. Parashikohet që programi të nisë në vendet e Evropës Juglindore dhe të shtrihet më tej në vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Produktet e sigurimit që do të ofrohen.

Programi do të mbështesë futjen e produkteve me kosto të ulët të sigurimit të katastrofave në vendet e sipërpërmendura, çfarë aktualisht nuk ekziston në tregjet tradicionale të sigurimit në këto vende. Produkti kryesor i sigurimit që do të ofrohet nga siguresit e vendeve pjesëmarrëse dhe do të mbështetet nga SECE CRIF, do të jetë sigurimi i ndërtesave dhe

pajisjeve nga rreziqet e tërmetit dhe përmytjes, që do të blihet në mënyrë të veçantë nga pronarët e banesave dhe bizneset e mesme e të vogla. Kufijtë e mbulimit që do të ofrojnë ky sigurim, do të jenë të ndryshëm në vende të ndryshme, duke iu përafëruar vlerave mesatare të pronave në kryeqytetet e vendeve pjesëmarrëse. Polica standarde e sigurimit që do të ofrohet nga programi, do të përmbajë edhe një pjesë të zbritshme që mund të zvogëlohet me një shtesë mbi primin e sigurimit.

Mënyra e implementimit të programit. SECE CRIF do të organizohet si kompani e veçantë risigurimi, që do të risigurojë riskun e katastrofës të marrë në sigurim nga siguresit e vendeve pjesëmarrëse, nëpërmjet policave të shitura të sigurimit tek pronarët e banesave apo bizneset e mesme e të vogla sipas kushteve dhe termave të përcaktuara nga programi.

Kriteret e pjesëmarrjes në program të siguresve. Termat dhe kushtet e përmendura më sipër do të përfshijnë termat standarde të tarifimit të pronës për kategori të ndryshme të riskut, kriteret e marrjes në sigurim të riskut kryesor, nivelet e mbajtjes maksimale të rrezikut, kufijtë standardë të mbulimit dhe pjesët e zbritshme. Siguresit pjesëmarrës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat, për të garantuar vazhdimësinë e tyre në program.

Primet e përballueshme dhe stabiliteti i tyre.

Primi i përballueshëm i risigurimit do të mundësohet nga akumulimi i riskut përgjatë rajonit, çfarë do të shoqërohet me përfitimet që sjell diversifikimi i madh i riskut. Këto dy efekte pritë të përkthehen në prime të përballueshme dhe të qëndrueshme për të siguruarit në vendet pjesëmarrëse.

Pronësia dhe qeverisja e programit. Për shkak të rëndësisë së madhe që kanë politikat qeveritare në mbështetjen e kërkesës për

² SouthEastern and Central Europe Catastrophe Risk Insurance Facility

sigurimin nga katastrofat të pronarëve të banesave dhe bizneseve të mesme e të vogla, programi fillimisht do të jetë në pronësi dhe udhëheqje të vendeve pjesëmarrëse. Këto vende do të përfaqësohen në mbledhjen vjetore të aksionerëve nga ministritë përkatëse të financave. Me rritjen e dallueshme të nivelit të penetrimit të sigurimit të katastrofës, qeveritë pritet të shesin aksionet e tyre tek investitorët privatë.

Roli i qeverive. Vendet pjesëmarrëse do të jenë aksionerët kryesorë dhe në të njëjtën kohë përfituesit më të mëdhenj të programit të propozuar. Suksesi i tij do të jetë i lidhur me vullnetin dhe mundësinë:

- o Për të hartuar dhe miratuar kuadrin ligjor që lidhet me veprimtarinë e programit;
- o Për ndërmarrjen e fushatave informative dhe ndërgjegjësuere për publikun, për mundësitë dhe përfitimet që ofrojnë produktet e sigurimit të katastrofave;
- o Për pjesëmarrjen aktive në qeverisjen e programit.

Roli i siguriesve dhe risiguriesve. Suksesi i programit do të lidhet me shoqëritë e sigurimit. Ato do të shesin policat e sigurimit tek pronarët e banesave dhe bizneset e mesme e të vogla në vendet pjesëmarrëse dhe do të merren me trajtimin e dëmeve.

Për të transferuar riskun e akumuluar nga shitja e produktit të sigurimit të katastrofës, siguriesit do të lidhin një kontratë risigurimi me programin SECE CRIF, që do të mbulojë deri në 100% të rrezikut të marrë në sigurim nëpërmjet policave të shitura. Mbulimi në risigurim do të jetë automatik, për të gjitha policat e sigurimit të shitura nga siguriesi, në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e marrjes në sigurim të programit. Siguriesit

gjithashtu do të merren me trajtimin e dëmeve e katastrofave të mbuluara në sigurim. Për trajtuesit e dëmeve të shoqërive do të ofrohen trajnime që do të garantojnë nivel të lartë profesionalizmi në të gjithë rajonin. Siguriesit do të marrin komisione risigurimi dhe pagesa që lidhen me kostot e trajtimit të dëmeve nga programi. Në rastet kur siguriesit shprehin interesin të marrin pjesë në mbulimin e riskut, atyre do t'u mundësohen mbajtje deri në 10 – 15% të riskut të siguruar, mbi baza të ndarjes përpjesëtimore. Për pjesën e riskut të mbajtur, siguriesit do të mbajnë pjesën përkatëse të primit, përveç komisionit të risigurimit. Mbajtja e riskut nga siguriesit do të kërkojë nga siguriesi mbajtjen e një kolaterali të veçantë për këtë qëllim.

Për të menaxhuar akumulimin e riskut, programi do të lidhë kontrata retrocesioni me risiguries dhe investitorë globale. Parashikohet që në 5 – 7 vitet e para, programi të cedojë deri në 90% të riskut tek risiguriesit globalë.

Roli i Bankës Botërore. Financimi i riskut të katastrofës dhe zhvillimi i tregjeve kombëtare të sigurimit të katastrofave përbëjnë prioritetet të Bankës Botërore në menaxhimin e riskut të katastrofave. Banka aktualisht po mbështet zhvillimin e qasjes rajonale të sigurimit të katastrofave, nëpërmjet financimit të kontributit për kapitalin e pjesëmarrjes nga vendet, përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore, gjetjen e donacioneve dhe lehtësimin e procesit teknik të regjistrimit të programit SECE CRIF.

Shqipëria, vendi i parë pjesëmarrës. Disa vende të rajonit kanë shprehur interes të madh për të marrë pjesë në programin rajonal të sigurimit të katastrofave. Në 16 Maj, Shqipëria u bë vendi i parë i programit SECE CRIF dhe mori një financim prej 2.5 milionë USD nga IBRD³ për të mbuluar kontributin me kapital në program dhe kostot e kryerjes së një fushate

³ International Bank for Reconstruction and Development

publike mbi rëndësinë dhe përfitimet e sigurimit nga katastrofat. Një përjasje e ngjashme pritet në 6 muajt në vijim në tre vende të tjera të rajonit.

Banka Botërore organizoi dhe financoi një takim pune teknik mbi rëndësinë e programit dhe mënyrat e funksionit të tij në Zurih, Zvicër në datat 23 – 23 Tetor 2008. Në të morën pjesë përfaqësues nga Banka Botërore, ekspertë të sigurimeve dhe risigurimeve dhe përfaqësues të vendeve të Evropës Juglindore. Shqipëria u përfaqësua në këtë aktivitet me përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

II. Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian e IOSCO - s

Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian (ERC) e IOSCO - s, u zhvillua në datën 3 nëntor 2008, në Madrid, Spanjë, në zyrat qendrore të IOSCO - s.

IOSCO është një organizatë ndërkombëtare që mbledh rregullatorë nga mbarë bota për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve të kapitalit.

Në strukturën e IOSCO - s, ndër të tjera, funksionojnë edhe katër komitete të specializuara rajonale me anëtarë sipas rajoneve, të cilët mbledhen për të diskutuar problemet rajonale. Këto komitete janë:

- o Komiteti Evropian.
- o Komiteti i Afrikës dhe Lindja e Mesme.
- o Komiteti Aziatik dhe Pacifik.
- o Komiteti Inter Amerikan.

Në mbledhjen e radhës së Komitetit Rajonal

Evropian, në të cilin AMF është anëtare, mori pjesë **z. Keler Gjika**, nënkryetar i AMF-së.

Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit të IOSCO-s, ishte një ndër problemet që u trajtuan në këtë mbledhje.

Në mbledhje u dha një informacion mbi:

o Progresin e aplikantëve në MMoU, anëtare të ERC-së. Nisur nga strategjia e re e IOSCO - s, që deri në Janar 2010 të gjithë anëtarët e IOSCO -s duhet ta nënshkruajnë MMoU, Shqipëria ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të aplikuar për nënshkrimin e saj. AMF vlerëson shumë të rëndësishëm procesin e bashkimit në grupin e nënshkruesve të MMoU - së dhe si një hap drejt konsolidimit të mbikëqyrjes së tregut të letrave me vlerë, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete homologe. Një grup pune është ngritur në AMF, për t'i dhënë këtij procesi rëndësinë e duhur. Ndryshimet në kuadrin ligjor me hyrjen në fuqi të ligjit " Mbi Letrat me Vlerë" në mars të 2008, kanë nxitur procesin për në stadin përfundimtar.

o Mbi punën dhe aktivitetin e Komitetit që nga mbledhja e fundit, e cila u zhvillua në kuadrin e mbledhjes vjetore të IOSCO - s në qershor 2008.

o përafrimin e rregullatorëve midis vendeve jo anëtare të BE - së (rasti i Shqipërisë) me ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

Anëtarët e Komitetit Rajonal Evropian, përmes diskutimeve të dobishme, treguan mundësitë për lehtësimin e këtyre përafrimeve. Shkëmbimi i pikëpamjeve u fokusua në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me:

- o Veprimtarinë në shërbimet ndërkufitare të siguruesve të shërbimit të investimit,
- o shpërndarjen e fondeve të investimit (UCITS) midis vendeve të BE - së dhe vendeve anëtare të ERC, jo anëtare në BE,

- o infrastrukturën tregtare dhe post tregtare,
- o rregullimet ligjore të autoriteteve mbikëqyrëse për të siguruar një mbikëqyrje efektive të tregut, për vendet të cilat nuk kanë nënshkruar marrëveshjen e MMOU.

Një çështje tjetër e trajtuar ishte edhe *MiFID* (*Market in Financial Instruments Directive*), tregu në kuadrin e Direktivës mbi Instrumentet Financiare dhe efektet ndërkufitare. U dhanë eksperiencat e vendeve të BE - së si: FSA - Londër dhe AMF - Francë, për implementimin e MiFID në vendet e tyre. Qëllimi ishte të jepej një eksperiencë e tyre pas një viti aplikimi.

FBC - Zvicër dhe ISA - Izrael, prezantuan ndikimin dhe aplikimin e MiFID në vendet e tyre, megjithëse nuk janë pjesë e BE - së. Integrimi i tregjeve ndërkombëtare, bën që efekti i MiFID të shtrihet dhe jashtë vendeve të BE - së.

Një vend të rëndësishëm në takim zuri dhe ndikimi i krizës financiare globale dhe reagimi i rregullatorëve, ku u trajtuan zhvillimet më të fundit në vendet pjesëmarrëse. Në mbledhje u diskutuan dhe prioritetet e ERC - së për dy vitet e ardhshme.

III. Zhvillohet Konferenca e 4-t Ndërkombëtare “Për Sigurimin e Jetës në Evropën Lindore, CIS dhe Azi.”

Në datat 13-14 nëntor, Varshavë, Poloni, u zhvillua Konferenca e 4-t Ndërkombëtare “Për Sigurimin e Jetës në Evropën Lindore, CIS dhe Azi.”

Gjatë konferencës u trajtuan dhe diskutuan çështje të tilla, si:

- o *Projekti mbi Solvency II*, prezantuar nga Dr. Kurt Wolfsdorf, Kryetar i Sektorit të Jetës në Shoqatën Ndërkombëtare të Aktuarëve (IAA), i cili solli eksperiencën gjermane në këtë drejtim. Në këtë prezantim u theksuan ndryshimet midis sistemit që përdoret aktualisht dhe parimeve të vlerësimit të riskut në një treg konsistent, duke pranuar faktin se nga njëra anë aplikimi i standardeve të Solvency II është shumë kompleks dhe i vështirë, por nga ana tjetër është shumë i domosdoshëm në krijimin sa me shpejt i tij.
- o *Sigurimi i jetës në ditët tona*, prezantuar nga Presidenti dhe CEO i RGA (Grupi i risigurimit të Amerikës). Referuesi bëri një paraqitje të detajuar të origjinës, zhvillimit dhe pasojave të krizës financiare botërore e fokusuar kjo në industrinë e sigurimeve. Nisur nga fakti që kjo krizë financiare do të pasohet me një kolaps ekonomik, referuesi sugjeroi që kompanitë e sigurimeve të jetës t'i kthehen produkteve bazë, tradicionale të sigurimit dhe marrëdhëniet me klientët të mbështeten në besimin e përbashkët.
- o *Tendencat e sigurimit të jetës në tregjet e Evropës Lindore dhe tregun Aziatik, roli i kapitalit të huaj, përfshirë IFC në zhvillimin e tregjeve të sigurimit të jetës*, prezantuar nga përfaqësuesi i IFC, (Martin Buehler, principal insurance officer), i cili theksoi kërcënimet që i kanosen tregjeve të reja në zhvillim të vendeve të Evropës Lindore dhe Azisë. Nga njëra anë kriza ka sjellë ndërprerje të investimeve të grupeve të Evropës Perëndimore në këto rajone dhe probleme serioze të institucioneve financiare lokale, veçanërisht në sistemin e pensioneve. Nga ana tjetër kriza duke prekur me shumë kompanitë e sigurimeve të vendeve perëndimore, ofron mundësi të reja për kompanitë lokale.

- o *Tregu i sigurimi të jetës dhe pensione në Poloni*. Referuesit theksuan, se kompanitë vendase të

sigurimeve i kushtojnë më shumë vëmendje liberalizimit të sektorit të sigurimeve shoqërore. Në kuadrin e krizës botërore, këto kompani duhet të sigurojnë që produktet e jetës të jenë të thjeshta dhe transparente dhe të garantojnë përfitim për klientin, duke sjellë legjislacionin Polak në fuqi në korrelacion me standardet e EU. Gjithashtu u paraqitën edhe marrëdhëniet shumë të ngushta midis të punësuarve dhe kompanive të sigurimit lidhur me benfitet e të punësuarve në skemat e pensione.

o *Tregu i sigurimit të jetës në Romani, Bullgari, Rusi, Ukrainë, Bjellorusi, duke u fokusuar në kuadrin legjislativ dhe praktikat e sigurimit të jetës të secilit vend.* Kryetari i Autoritetit Mbikëqyrës të Federatës Ruse, prezantoi zhvillimin dhe strukturën aktuale të tregut rus të sigurimit të jetës duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në hapat që janë ndërmarrë nga autoriteti për të eliminuar evazionin fiskal në këtë industri. Për të përfunduar këtë referim anëtar i Bordit Drejtues të Vienna Insurance Group, prezantoi arritje të shkëlqyera të sektorit të sigurimit të jetës në vendet e Evropës Lindore, tregjet e të cilave janë në rritje, të favorizuar edhe nga kushtet ekonomike dhe demografike pavarësisht krizës së sotme ekonomike financiare botërore.

Në këtë Konferencë morën pjesë rreth 150 profesionistë të fushës së sigurimeve, të niveleve më të larta menaxheriale të kompanive të sigurimit, përfaqësues të kompanive ndërkombëtare të sigurimeve dhe grupimeve financiare, bankave, drejtues të sektorëve të aktuaristikës, ekspertë të TI, këshilltarë dhe përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse shtetërore. Këta përfaqësonin 23 shtete, përfshirë vendet e Evropës Lindore, Azisë, Austri, Belgjikë, Greqi, Egjipt, Spanjë, Francë, Gjermani, Indi, Hollandë, Zvicër, Britani e Madhe dhe Amerikë.

IV. Zhvillohet takimi i përgjithshëm vjetor i IOPS dhe Forumi Global i OECD/IOPS për pensionet private “Zhvillimet e Pensioneve në Afrikë: Mundësi dhe Sfida”

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me OECD dhe Autoritetin e Përfitimeve të Pensioneve të Kenias, (RBA⁴) zhvilluan në Mombasa, Kenia gjatë periudhës 28-31 Tetor 2008, takimet e mëposhtme:

- a) Takimi i Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS në datë 28-29 Tetor 2008,
- b) Takimi i Përgjithshëm Vjetor i IOPS, 30 Tetor 2008, dhe
- c) Forumi Global i OECD/IOPS për Pensionet Private “Zhvillimet e Pensioneve në Afrikë: Mundësi dhe Sfida”, 30-31 Tetor 2008.

Takimi i radhës së IOPS pasoi takimin tremujor të mbajtur në Paris, në muajin Qershor 2008. Shumë projekte dhe studime të ndërmarra me parë u shqyrtuan për ecurinë dhe stadin e tyre të zhvillimit. Kështu në takimin e IOPS-it në Mombasa, u trajtuan tema të rëndësishme si: (i) Të reja rreth propozimeve të IASB⁵; (ii) Diskutim rreth ndikimit në skemat e pensione të krizës financiare aktuale; (iii) IOPS “Toolkit” për mbikëqyrjen mbi bazë risku – Kërkesat rregullatore dhe detyruese, Moduli 2; Tools për RBS – Kili, Gjermania, Republika Çeke, Moduli 3; Modelet e Risk Scoring, Kenia, Afrika e Jugut, Holanda, Moduli 5; Si të formulohet qëndrimi i mbikëqyrjes për të identifikuar riskun, Australia, Hungaria, UK, Bostwana, Moduli 6; Arkitektura e menaxhimit të riskut, OECD, Moduli 1; Roli i disiplinës së tregut, Italia, Moduli 7; (iv) Rregulloret e licencimit dhe struktura mbikëqyrëse e pensione private: Eksperienca ndërkombëtare

⁴ Retirement Benefit Authority

⁵ International Accounting Standards Bureau

dhe ndikimet në Kinë, etj.

Nga diskutimet u tërhoq vëmendja që në situatën financiare aktuale po dalin në pah risqe të reja. Kështu krahas riskut të tregut (market risk), riskut të interesit (interest rate risk), riskut të kredisë (credit risk), riskut të koncentrimit (concentration risk), riskut operacional (operational risk) po shfaqet edhe risku i sjelljes (behaviour risk). U përmend shembulli i Sllovakisë ku po vihet re një tendencë që anëtarët e kolonës së dytë po kërkojnë të kthehen në kolonën e parë.

Në lidhje me politikën që duhet ndjekur u dhanë këto rekomandime: i) të intensifikohet mbikëqyrja së bashku me qeverinë, ii) të zhvillohen takime me industrinë, iii) të ketë me shumë limite për investimet (disa limite kanë rezultuar që janë shumë të ulta), iv) realizimi me i shpeshtë i stress testeve, përditësimi i tyre, v) politika me fleksibël në fazën e annuity, të shikohet mundësia që detyrimet për pensionet të kenë volatility më afatgjatë. Për të zgjidhur këto probleme shumë të rëndësishme duhet gjithashtu vi) të bëhen kërkesa më të detajuara për raportim, vii) dhënia e mundësive me të zgjatura në kohë për rikuperim (shembulli i Hollandës që ka aplikuar një periudhë 8 mujore për të marrë një plan rikuperimi nga shoqëritë e pensioneve). Gjithashtu si alternative mund të shikohet edhe ix) politika e rritjes së primeve, x) komunikimit me industrinë, jo panik; dhe xi) edukimit financiar të njerëzve në lidhje me rreziqet për përfitimet e pensioneve.

Ndërsa në Forumin Global të OECD/IOPS për Pensionet Private “Zhvillimet e Pensioneve në Afrikë: Mundësi dhe Sfidë”, ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan mund të veçojmë: (i) Roli i Sistemeve të Pensioneve Private në Vendet në Zhvillim - Industria e Pensioneve në Kenia dhe në vende të tjera të Afrikës; (ii) Fushata e Edukimit Financiar dhe Reforma e Pensioneve - Eksperienca e Irlandës, Kenias,

dhe Polonisë; (iii) Mbulimi i Fondeve të Pensioneve dhe Sektori Informal – Eksperienca e Indisë, Kilit dhe Afrikës së Jugut; (iv) Fondet e Pensioneve në Tregun e Kapitaleve dhe Zhvillimet në Infrastrukturë – Amerika Latine, Afrika e Jugut, Uganda, Kenia.

Temat e paraqitura u trajtuan me shumë profesionalizëm dhe pati mjaft diskutime dhe pyetje rreth tyre.

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

Kapitulli 1

Nevoja në rritje për ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi risqet dhe çështjet e sigurimeve
(Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private)

1. Evoluimi i risqeve dhe nevojave të shoqërisë për mbulim me sigurim

Rritja e risqeve të njohur dhe realë

Risqet e reja dhe të katastrofës janë aspektet më të prekshme të rritjes së niveleve të risqeve. Për disa vite me radhë, shumë shtete të OECD, janë përballur me rishfaqjen e risqeve, shkalla dhe frekuenca e të cilave do të ishte e vështirë të imagjinohej më parë, përfshi këtu terrorizmin modern, sidomos ai i 11 shtatorit të vitin 2001, si dhe disa katastrofa natyrore me pasojat e tyre të rënda. Termat “risk society” (risku i shoqërisë) ose edhe “fear society” (frika e shoqërisë), gjithmonë e më shumë përdoren që të reflektojnë tek njerëzit një perceptim të ngushtë për rritjen e ekspozimit të tyre ndaj risqeve madhore, si për risqet në zhvillim ato të katastrofave, ashtu edhe ndaj risqeve individuale, si plakja, sëmundjet, humbja e të ardhurave dhe risqeve të tjera financiare dhe ekonomike.

Gama e risqeve tradicionale dhe atyre me shkallë të gjerë, duket të jetë zgjeruar, me rritjen e frekuencës së ndodhjes së tyre. Ato përfshijnë risqe që lidhen me katastrofa industriale dhe natyrore, pasojat e panjohura të ndryshimit të klimës, sulmet terroriste dhe risqe të lidhura me teknologjitë e reja (si p.sh: përhapja e internetit dhe e informacionit si dhe shoqëria multimediale), rreziqe të shëndetit si ato që lidhen me asbestin, mykun, obezitetin dhe rreziqe të reja si AIDS dhe gripi i pulave, po ashtu dhe rreziqe që kanë të bëjnë me ndryshimet demografike dhe si rezultat i rritjes së jetëgjatësisë.

Natyra e re e disa prej risqeve dhe trajtimi i tyre nga media (sidomos ato të lidhura me pasoja katastrofike ose që kanë një efekt direkt në shëndetin publik) në përgjithësi ndikojnë në një nocion të përgjithshëm të një niveli më të lartë risku. Megjithatë, përveç kësaj, shkalla dhe shumëllojshmëria e mënyrave se si këto risqe ndikojnë në mënyrë drastike në jetën e njerëzve dhe funksionimi i sistemit ekonomik dhe social, është një çështje shqetësuese për shoqërinë, veçanërisht sepse mënyra e parandalimit dhe e vlerësimit përpara se ato të ndodhin janë akoma të pazhvilluara.

Rritja e nevojave dhe kërkesave për sigurimin ndaj rreziqeve

Në këto 10 vitet e fundit, kjo rritje e rreziqeve të reja madhore, po shoqërohet me financime të ulëta nga qeveria për të financuar pasojat lidhur me riskun tradicional dhe individual në fusha si plakja, kujdesi për shëndetin, zëvendësimi i të ardhurave në shumë vende të OECD.

Në të njëjtën kohë, punëdhënësit në shumë vende të OECD - së, sidomos kompanitë e mëdha, kanë reduktuar gjithashtu mbulimin e një numri të caktuar të këtyre risqeve si rrjedhojë e heqjes së programeve sociale të punonjësve, duke përdorur gjithnjë e më shumë kontrata pune jo tradicionale dhe jo standarde.

Kontratat fikse dhe ato të përkohshme, përdorimi i stafit të agjencive apo të kontraktorëve të pavarur të vetëpunësuar, fenomen që po rritet gjithnjë e më shumë në vendet e OECD - së, nuk ofrojnë domosdoshmërisht të njëjtin nivel sigurimi dhe mbrojtjeje sociale apo në grup. (sidomos për pensionet, ndihmën sociale dhe shëndetësore). Në këtë kontekst, kur jetëgjatësia e popullsisë është në rritje, qytetarët kanë nevojë për më shumë mbrojtje kundrejt risqeve të shëndetit dhe të plakjes dhe për të plotësuar apo zëvendësuar mbulimin e reduktuar të pensionit publik apo atë të shëndetit. Nevojat individuale për të mbuluar rritjen apo shfaqjet e reja të risqeve personale, po rriten paralelisht me rritjen ekonomike dhe zhvillimin social. Të ardhurat dhe kapaciteti personal për të kursyer, gjithashtu kanë pësuar një rritje në shumë vende në zhvillim gjatë dekadës së fundit. Një pjesë e madhe e popullsisë tashmë kanë kursime të cilat mund t'i investojnë. Këto fonde parash po përdoren jo vetëm për produkte financiare por edhe për mallra shtëpiake apo të mira të tjera materiale, që gjithashtu kërkojnë sigurim dhe mbrojtje të përshtatshme (përfshirë risqet potenciale të një shkalle të lartë). Fakti që konsumatorët marrin edhe më shumë kredi për të bërë të tilla blerje, e kanë zmadhuar riskun e dëmeve apo mungesës së të ardhurave në raste aksidenti apo paaftësie.

Përgjegjësia e shoqërisë për risqet në tërësi dhe zgjedhjen e mbulimit

Shtimi i përgjithshëm i një grupi risqesh të ndryshëm të kombinuara me pakësimin e financimit publik dhe të shoqërive kundrejt rreziqeve sociale në shumë vende të OECD, nënkuptojnë një rol më të madh për sigurimet që të plotësojnë dhe kompletojnë skema publike ose solidariteti. Qëllimi dhe mënyrat e këtij roli mund të ndryshojnë në varësi të specifikimeve të

juridiksioneve dhe në veçanti, të ndërhyrjeve nga qeveria, për mbulimin e tipeve dhe niveleve të ndryshme të risqeve. Në shumë vende, qeveria tenton të marrë pjesë më shumë, të paktën në sigurimin e pjesshëm të risqeve të një shkalle të gjerë.

Gjithashtu, disa skema sociale mbrojtëse ofrojnë mbulime më bujare për risqet bazë si shëndeti, pensionet dhe papunësia, ku sigurimet private thjesht janë plotësuese. Duke folur në përgjithësi, gjithsesi, terreni i mbulimit të riskut nga sigurimet private është zgjeruar dhe tani përfshihen aspekte të ndryshme në nivele të caktuara të jetës individuale.

Këto ndryshime vërtetojnë që individët / shoqëritë janë më drejtpërdrejtë të përgjegjshëm në përcaktimin dhe vlerësimin e risqeve potenciale që ato duan të sigurojnë, zgjedhjen e kushteve dhe niveleve të mbulimit të sigurimit të tyre. Si rrjedhojë, ky evoluim vë theksin në nevojat thelbësore për të rritur njohuritë, informimin dhe edukatën e konsumatorëve.

2. Kompleksiteti në rritje i produkteve të sigurimit, tregjeve dhe rregullimit

Brenda kontekstit të rritjes së rëndësisë të zgjidhjeve të sigurimit privat, për të mbuluar një gamë të gjerë risku dhe kërkesë për mbrojtje dhe kurse, sofistikimi dhe zhvillimi i produkteve të sigurimeve, si dhe shumëllojshmëria e siguruesve, rrisin nevojat e konsumatorëve për të patur informacionin dhe edukimin e duhur në lidhje me çështjet e sigurimeve.

Kompleksiteti dhe evoluimi i produkteve të sigurimit

Kompleksiteti dhe heterogjeniteti relativ i policave të sigurimit, shpesh i referuar si asimetri informacioni midis konsumatorëve jo ekspertë dhe siguruesve, mund ta bëjë më të

vështirë për konsumatorët të krahasojnë me efektivitet policat e sigurimit.

Përveç kësaj, dalja në pah e produkteve të sigurimit, të cilat përfshijnë një transferim më të madh të një risku tek i siguruari, ka nevojë për një nivel të caktuar njohurie dhe diturie në sigurime nga ana e bizneseve vendase.

Kompleksiteti dhe specifikat e produkteve të sigurimit

Me synimin për tu siguruar nga risqet në mënyrë sa më të përshtatshme dhe për të zvogëluar rrezikun moral dhe seleksionimet e pafavorshme, siguruesit kanë krijuar klauzola për të përcaktuar më mirë mbulimin e nënshkruesit të mundshëm. Për të analizuar shtrirjen e mbulimit të propozuar, konsumatori duhet të jetë në gjendje të kuptojë klauzolat që përjashtojnë disa risqe ose disa konsumatorë për arsye moshe, shëndeti, të ardhurash, e kështu me radhë, si dhe kufizime për garanci (më konkretisht, zbritjet, bashkësigurimin, kufijtë maksimal), kritere të ndryshme që përcaktojnë rastet që shkaktojnë nisjen e procesit të kompesimit dhe termat e kushtet për rinovimin e kontratave, parashtrimin e kërkesave për dëmshpërblim, etj. Këto kushte, klauzola dhe efektet e tyre mbi mbulimin nga policat e sigurimit përkatëse, kërkojnë njohje shtesë nga konsumatori për produktet e sigurimit, si dhe gjithashtu një informim të hapur nga ana e atyre që shesin apo ofrojnë polica sigurimi. Ky nivel i lartë i njohjes dhe aftësive financiare nuk arrihet asnjëherë nga konsumatorët që nuk janë specialistë të fushës. P.sh në Australi, në vitin 2002, ndërsa 65% e konsumatorëve kishte njohuri të mira në lidhje me mundësitë e tyre të sigurimit, 70% e tyre kishin vështirësi për të kuptuar kontratat e tyre individuale të sigurimit. Për më tepër, kushtet dhe të dhënat themelore ndryshojnë në varësi të llojit të sigurimit. Për kontratat e sigurimit të jetës, theksi vihet mbi rëndësinë e kostos të administrimit fillestar, si dhe të kompensimit në rastin e përfundimit parakohe të policës, maturimi, afati kohor minimal (p.sh për sigurimin e përkohshëm të jetës), opsionet e daljes nga polica, kushtet e dorëzimit, etj. Në këtë

drejtim, në Britaninë e Madhe kërkimet tregojnë se shumica e të siguruarve nuk kuptojnë plotësisht kontratat që kanë mbyllur ose kanë një ide të përgjithshme por nuk janë plotësisht të qartë, p.sh për anulimin e parakohshëm të një kontrate.

Për sa i përket policave të jo jetës, konsumatorët duhet që në mënyrë të veçantë të kuptojnë dhe të zgjedhin nivelin dhe qëllimin e duhur të mbulimit e riskut që përfshihet. P.sh sigurimi motorik ndaj palëve të treta madje polica e sigurimi motorik “gjithpërfshirës i dëmeve” nuk i mbulojnë dëmet fizike të të siguruarit në rast aksidenti (nëse nuk është cilësuar) dhe nuk përcaktojnë zbritjet dhe kufijtë maksimalë të kompensimit në varësi të dëmeve të ndodhura. E para, këto përjashtime dhe kufizime të mbulimit nuk janë gjithmonë transparente. E dyta, ato mund të mos jenë në dijeni të konsumatorëve jo specialist të fushës, në rast se ata nuk informohen qartë përpara mbylljes së kontratës. Për më tepër, në mungesë të një kuadri rregullativ më specifik, pjesa më e madhe e policave standarde për sigurimin e shtëpive gjithmonë e më shumë përjashtojnë shkallë të larta risqesh (p.sh terrorizmi, katastrofa natyrore duke përfshirë përmbajtjet dhe dëme të shkaktuara nga asbesti), për të cilën siguruesit propozojnë një policë më vete. Akoma konsumatorët nuk janë medoemos në dijeni të risqeve të tilla që janë të përjashtuara nga polica, ose ata nuk kanë dëshirë të paguajnë prim shtesë për të mbuluar këto risqe. Anasjelltas, kompleksiteti i produkteve të sigurimit mund t'i bëjë individët të blejnë polica sigurimi që përkojnë me njëra tjetrën; p.sh dy polica sigurimi të ndryshme që mbulojnë të njëjtin risk. Për shembull, individët mund të nënshkruajnë polica sigurimi të udhëtarit që mbulon kostot e shëndetit dhe/ose të pronës personale kur janë

jashtë shtetit; ndërkohë ky mbulim mund të jetë i përfshirë në sigurimin e shëndetit privat dhe/ose në policën e sigurimit si pronar shtëpie.

Për më tepër, policat që mbulojnë risqe potencialisht afatgjata ose risqe që ndodhin relativisht rrallë (jeta, varësia, katastrofa të përmasave të mëdha) munden në fakt të vlerësohen vetëm pas një periudhe të gjatë kohe nga nënshkrimi i policës dhe kjo përgjithësisht nuk ndodh rregullisht. Kjo do të thotë se për të zgjedhur fillimisht këto lloj policash duhet të jepet informacioni i duhur në mënyrë që të përputhen me nevojat afatgjata të shoqërisë vendase. Kjo shpesh ndërlikohet nga mungesa e eksperiencës së konsumatoreve për këto lloje produktesh, të cilat blihen rrallë dhe që zakonisht nuk mund të nxjerrin mësim nga eksperiencia e brezave të mëparshëm kur pajisen me polica të tilla.

Vijon në numrin tjetër ...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, A. Qamo
L. Rama, Dh. Hazbiu, R. Eltari
E. Beqiraga, E. Kokona



amf ALBANIA
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

PUBLIKIM MUJOR I AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, NR. 13, NENTOR 2008

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni

Rr. "Perlat Rexhepi", Kati II, Tiranë / Tel: +355 42 247 148, 250 686 / Fax: +355 42 250 686

amf@amf.gov.al / www.amf.gov.al